



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry Of Environment, Spatial Planning And Infrastructure



AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS
KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE
KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY

RAPORT I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË



RAPORT I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË

VITI RAPORTUES 2021



Prishtinë, 2023



PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	1
LISTA E TABELAVE, FIGURAVE DHE HARTAVE	3
1.0 HYRJJE	3
1.1. Qëllimi i raportit.....	3
1.2. Fushëveprimi i raportit.....	4
1.3. Metodologjia e mbledhjes së të dhë 5	5
2.0 Korniza ligjore për menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë	6
3.0 MENAXHIMI I MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË	7
3.1. Gjendja aktuale.....	7
3.2. Gjenerimi i mbeturinave komunale.....	8
3.3. Deponimi i mbeturinave komunale	11
3.4. Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale.....	12
3.5. Faturimi dhe Arkëtimi.....	16
3.6. Deponitë e egra	20
3.7. Efikasiteti i kostos së menaxhimit të mbeturinave komunale	23
3.8. Sistemet e ndara për mbeturinat e veçanta	25
3.9. Ndarja e mbeturinave-Riciklimi.....	26
3.10. Pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të mbeturinave	28
GJETJET E RAPORTIT	30
REKOMANDIMET	31
REFERENCAT	33
SHTOJCAT	

SHKURTESAT

MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
JICA	Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
UA	Udhëzimet Administrative
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
MK	Mbeturinat Komunale
MV	mbeturinat e vëllimshme
N & D	Ndërtimit dhe demolimit
Mko	Mbeturinat komerciale
LM	Ligji për Mbeturina
PKMM	Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave
PAMKOS	Shoqata e kompanive rajonale të menaxhimit të mbeturinave
PMM	Plani për menaxhimin e mbeturinave
RrKMB	Rregullorja komunale për menaxhimin e mbeturinave
DR	Deponi rajonale
KRM	Kompani rajonale e mbeturinave
KP	Kompani private
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
SMIM	Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave
KMDK	Kompania për Mneaxhimin e Deponive në Kosovë
MM	Menaxhimi i mbeturinave

Lista e tabelave, figurave dhe hartave

- Tabela 1.** Sasia e MK të gjeneruara dhe të grumbulluara 2021;
- Tabela 2.** Sasia e MK të deponuara/shprehur në ton;
- Tabela 3.** Mbulimi me shërbim të mbledhjes së MK, (2020 & 2021);
- Tabela 4.** Faturimi dhe arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2021);
- Tabela 5.** Shkalla (%) e arkëtitimit për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2020 & 2021);
- Tabela 6.** Numri i deponive të egra ndër vite sipas rajoneve;
- Tabela 7.** Deponitë e egra sipas kompozicionit, 2021;
- Tabela 8.** Efikasiteti i kostos së menaxhimit të mbeturinave, 2021;
- Tabela.9.** Sitemet e ndara për mbeturina të veçanta, 2021;
- Tabela 10.** Mbeturinat e trajtuara sipas llojit për vitin 2021/t (ASK);
- Tabela 11.** Pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të mbeturinave, (2020 & 2021);
-
- Figura 1.** Gjenerimi i MK sipas rajoneve dhe në nivel vendi shprehur në kg/banor/vit, (2020 & 2021);
- Figura 2.** Trendi i deponimit të mbeturinave komunale;
- Figura 3.** Mbulimi me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK nga ekonomitë familjare sipas komunave, (2020 & 2021);
- Figura 4.** Mbulimi me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK për ekonomitë familjare sipas rajoneve dhe në nivel vendi, (2020 & 2021);
- Figura 5.** Arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2020 & 2021);
- Figura 6.** Arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2020 & 2021);
- Figura 7.** Numri i deponive të egra sipas rajoneve dhe në nivel vendi;
- Figura 8.** Deponitë e egra sipas kompozicionit në nivel vendi;
- Figura 9.** Niveli (%) i plotësimit të proceseve të kërkuara në nivel vendi, (2020 & 2021);
-
- Harta 1.** Gjenerimi i MK në komuna shprehur në kg/banor/vit (2020 & 2021);
- Harta 2.** Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK sipas komunave, (2020 & 2021);
- Harta 3.** Shkalla e arkëtitimit për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2020 & 2021);
- Harta 4.** Deponitë e egra sipas komunave, (qershor 2021);

1.0 HYRJJE

1.1. Qëllimi i raportit

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), bazuar në LIGJI NR.03/L-025 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT e ka në përgjegjësi hartimin dhe publikimin e raporteve mbi gjendjen e mjedisit në Kosovë. Bazuar në LIGJI NR. 04/L-060 PËR MBETURINA - SHTOJCA, si dhe LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA, AMMK është përgjegjëse për përgatitjen dhe publikimin e raportit mbi gjendjen e mbeturinave në Kosovë.

Andaj, AMMK sikurse edhe për vitet paraprake, edhe për vitin 2021 ka finalizuar raportin mbi gjendjen dhe menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë.

Përmes këtij raporti është synuar që të sigurohet një bazë të fortë dhe gjithëpërfshirëse e të dhënave mbi menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë. Të dhënat e prezantuara në këtë raport pasqyrojnë relativisht mirë gjendjen dhe menaxhimin të mbeturinave komunale, trendeve, problemeve si dhe masave dhe planifikimeve për të ardhmen.

Një nga objektivat e këtij raporti, është që të dhënat dhe të gjeturat e prezantuara në këtë raport, të shfrytëzohen nga politikbërësit qoftë nga niveli qendrorë, e sidomos nga niveli lokal, me qëllim që të politikat e menaxhimit të mbeturinave komunale të planifikohen dhe të orientohen drejtë.

Pas miratimit të Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2021-2030 (SMIM) dhe Planit për Menaxhimin e Mbeturinave 2021-2023 (PMM), është planifikuar një qasje e re dhe më vizionare me objektive strategjike, që do të luajnë një rol të rëndësishëm edhe në aspektin e përmirësimit ekonomik dhe standardit jetësorë.

Këta objektiva janë menduar në kuptimin e zhvillimit dhe përmirësimit të shërbimeve dhe infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbeturinave, rritjen dhe avancimin e sektorit të riciklimit të mbeturinave, rritjen e kontrollit të përgjegjësive dhe zbatimit si dhe promovimin e praktikave më të mira të menaxhimit të mbeturinave, e sidomos duke i dhënë një përqendrim më të theksuar ekonomisë qarkore.

Ndërkaq në nivelin lokal të qeverisjes, komunat poashtu kanë intensifikuar përpjekjet e tyre për të përmirësuar gjendjen në këtë segment të qeverisjes, ku menaxhimin e mbeturinave tani e shohin si një nga prioritetet në planifikimet e tyre zhvillimore.

Komunat kanë filluar me rishikimin e planeve komunale të menaxhimit të mbeturinave, ndarjen e buxheteve specifike për menaxhim të mbeturinave, ndërmarrjen e aktiviteteve direkte në pastrimin e deponive të egra, aktiviteteve për promovimin e vlerave të mjedisit, pjesëmarrjen aktive në projekte të ndryshme mjedisore, bashkëpunimin me donatorë etj.

Poashtu, kemi vërejtur se është përmirësuar dukshëm ofrimi i shërbimit për mbeturina për qytetarët dhe klientët tjerë, dhe një gatishmëri më e madhe nga ana e komunave që duke pasur parasysh edhe mundësitë financiare, të futen në realizimin e projekteve të ndryshme, me qëllim të përmirësimit të gjendjes në këtë fushë.

Në këtë raport janë pasqyruar të dhënat e menaxhimit të mbeturinave nga 35 komuna të vendit që kanë raportuar në AMMK për vitin 2021.

Edhe këtë vit raportues, AMMK ka pasur një mbështetje dhe bashkëpunim të ngushtë me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), me Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) si dhe me secilën komunë në veçanti.

Ky bashkëpunim i ndërsjellë është ndërtuar gjatë bashkëpunimit që të gjitha palët e lartëcekura kemi pasur në realizimin e “Grantit të Performancës Komunale – “Mjedisi i Pastër” (2018-2020), ku komunat janë mbështetur me shuma të ndryshme financiare, varësisht prej nivelit të përmbushjes së indikatorëve të fushës së mbeturinave.

Zhvillime pozitive në fushën e menxhimit të mbeturijnave presim edhe në vitet në vijim, pasi nga donatorët si BE, GIZ, JICA etj. ka sinjale pozitive të vazhdimit të mbështetjes përmes investimeve në fushën e menaxhimit të mbeturinave. Këto investimet do të jenë të natyrës direkte, por edhe përmes ngritjes së kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve, zhvillimin e hulumtimeve dhe aspekteve tjera të mbështetjes teknike.

Megjithatë, investimet në projekte të mëdha kërkojnë analizë gjithëpërfshirëse dhe ato duhet të jenë të bazuara në dokumentet si Strategjia dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë, por poashtu edhe në qasjen dhe trendet që aktualisht janë duke u zhvilluar në BE.

Thkesojmë se në këtë raport jemi munduar që të pasqyrojmë sa më realisht gjendjen me të cilën ballafaqohet Kosova dhe komunat individualisht, sa i përket menaxhimit të mbeturinave komunale. Kemi vërejtur se në rrethana të caktuara disa komuna qëndrojnë më mirë në këtë drejtim, kurse disa të tjera qalojnë.

Në përmbajtjen e këtij raporti janë paraqitur të dhënat për vitin raportues 2021, dhe për të pasqyruar progresin në këtë sektor kemi përdorur metodën e krahasimit të të dhënave me të dhënat e viteve paraprake.

1.2. Fushëveprimi i raportit

Përmes këtij raporti është synuar që të arrihet një përmbushje e kërkesave të legjislacionit dhe dokumenteve planifikuese të menaxhimit të mbeturinave komunale. Janë prezantuar të dhëna mbi gjendjen e mbeturinave të ngurta të parrezikshme që gjenerohen në nivel vendi, duke përfshirë: mbeturinat komunale (MK) nga amvisëritë; mbeturinat komerciale (MKo); mbeturinat e demolimit dhe ndërtimit (N&D), që do të thotë mbeturinat nga aktivitetet e ndërtimit dhe demolimit të objekteve banesore, civile dhe afariste; mbeturinat e vëllimshme (MV), që do të thotë mbeturinat nga amvisëritë dhe bizneset, dhe aspekte tjera.

Përmbajtja e këtij raporti paraqet një pasqyrë aktuale mbi gjendjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, përfshirë: zbatimin e legjislacionit, mbulimin me shërbim të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave, faturimin dhe arkëtimin, regjistrimin e deponive të egra, sasinë e mbeturinave komunale të grumbulluar dhe të gjeneruara sipas komunave, sasinë e mbeturinave të deponuara, të dhëna lidhur me nismat e komunave për ndarjen e mbeturinave në burim, efikasitetin e kostos së menaxhimit të mbeturinave komunale, menaxhimin e mbeturinave të veçanta etj.

1.3. Metodologjia e mbledhjes së të dhënave

Në 3 mujin e parë të vitit 2022, AMMK ka filluar me përgatitjet e nevojshme para fazës së raportimit (31 mars 2021), ashtu që me mbështetjen e GIZ-së, në bashkëpunim me Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK), si dhe me kompanitë e licencuara për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave komunale, janë zhvilluar takime ku është diskutuar dhe janë dhënë udhëzimet e duhura për formatin, procedurën, si dhe afatet e raportimit për menaxhimin e mbeturinave komunale për vitin 2021.

Në këtë raport janë prezantuar të dhënat që janë siguruar nga raportimi i 35 komunave, kompanive rajonale dhe lokale të licencuara që merren me mbledhje dhe transport të mbeturinave komunale (KRM) kompanitë e menaxhimit të deponive (KMDK) si dhe nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Në AMMK, përmes një procesi të administruar mirë këto të dhëna i janë nënshtruar procesit të vlerësimit të cilësisë dhe verifikimit të vërtetësisë. Verifikimi i vërtetësisë së të dhënave të raportuara është bërë përmes shkëmbimit të të dhënave plotësuese dhe dokumenteve tjera relevante që janë siguruar nga bashkëpunimi me komunat dhe KRM-të, por edhe përmes krahasimit të databazës së viteve paraprake që AMMK tashmë e ka të ndërtuar relativisht kënaqshëm.

Të dhënat në këtë raport pasqyrojnë gjendjen e menaxhimit të mbeturinave për vitin e katërt radhazi që në AMMK akterët e lartcekur raportojnë përmes formatit të unifikuar dhe të standardizuar të raportimit.

Raporti është hartuar duke përdorur të dhënat e raportuara nga:

- Komunat, përmes zyrtarëve komunal, përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave;
- Operatorët e mbledhjes dhe transportit të mbeturinave (KRM, Njësitë Komunale, etj.);
- Kompanitë e menaxhimit të deponive (KMDK, KRM etj.).
- Të dhëna nga ASK, si dhe;
- Të dhëna tjera plotësuese gjatë procesit të vlerësimit dhe verifikimit.

Për të verifikuar saktësinë e të dhënave të raportuara nga ana e komunave dhe kompanive, si për: numrin e amvisërive të shërbyera, shkallën e arkëtimit, sasinë e mbeturinave të gjeneruar dhe të deponuar, qasjen në infrastrukturën për ndarje e mbeturinave në burim, shkallën e përmbushjes së legjislacionit që rregullon fushën e menaxhimit të mbeturinave, regjistrimin e deponive të egra, vlerësimin e kosotos operative etj., nga komunat dhe operatorët është kërkuar dokumentacion shtesë i nevojshëm.

Këto dokumente dhe të dhëna shtesë përfshijnë: pasqyrat financiare, lista faturimi, raporte mbi sasinë e deponuara të mbeturinave, foto dhe koordinata nga lokacionet e deponive të egra, kontrata, PKMM dhe RrKMM për secilën komunë etj.

Rezultatet e të dhënave për deponitë e egra janë të bazuara nga regjistrimi në terren i realizuar në të gjitha komunat në mbarë vendin, në periudhën qershor 2022. Më pastaj, këto të dhëna janë raportuar në formularët e standardizuar të AMMK-së. Verifikimi i të dhënave të raportuara për deponitë e egra është bërë përmes vizitave në lokacione të përzgjedhura në terren.

I gjithë procesi i verifikimit të saktësisë së të dhënave të raportuara dhe i dokumenteve të lartpërmendura është realizuar nga grupi teknik brenda MMPHI-së, janë dhënë vlerësimet dhe janë nxjerrë rezultatet e raportit për menaxhimin e mbeturinave komunale për vitin 2021.

Pas vlerësimit të të dhënave është hartuar drafti preliminar i raportit të cilin AMMK e ka përcjellë tek komunat për ta shqyrtuar, dhe pasi kemi pranuar komente dhe vërejtjet konkrete nga komunat, grupi teknik i ka trajtuar dhe adresuar brenda afatit optimal.

2.0. Korniza ligjore për menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë

Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë është i përkufizuar dhe i rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina, respektivisht me Ligjin Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina.

Ky ligj ka për qëllim evitimin dhe reduktimin sa më të madh të gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimin e komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat, zhvillimi i qëndrueshëm përmes mbrojtjes dhe ruajtjes së resurseve natyrore, parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut, si dhe deponimi përfundimtar i mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.

Gjithashtu janë të miratuara edhe mbi 30 Udhëzime Administrative që e kanë bazën në këtë ligj. Udhëzimet administrative që ndërlidhen direkt me rregullimin e menaxhimit të mbeturinave komunale janë: Udhëzimi administrativ (QRK) Nr.08/2017 për menaxhimin e deponive të mbeturinave, U.A dhëzimi administrativ (QRK) Nr. 06/2016 mbi kushtet për zgjedhjen e lokacionit dhe ndërtimin e deponisë së mbeturinave, U.A. Nr.15/2012 për menaxhimin e deponive të mbeturinave, U.A MMPH - Nr. 27/2014 Për Menaxhimin e Mbeturinave nga Ambalazhet dhe Paketimet, U.A Nr. 16/2010 për Administrimin e Mbeturinave Biodegraduese., U.A Nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave etj.

Planifikimi dhe menaxhimi i mbeturinave është i rregulluar edhe me dokumente strategjike siç janë:

- Strategjia (2021-2030) dhe Plan i Veprimit (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë;
- Planet komunale për menaxhimin e mbeturinave;
- Rregulloret komunale për menaxhimin e mbeturinave.
- Planeve për menaxhimin e mbeturinave nga zotëruesit e mbeturinave;
- Planet për menaxhimin e mbeturinave nga personat e licencuar, etj.

Me miratimin e Strategjisë (2021-2030) dhe Planit të Veprimit (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë, menaxhimin të mbeturinave i është dhënë një prioritet dhe një qasje e re dhe më e përshpejtuar e realizimit të objektivave strategjik, që do të luajnë një rol të rëndësishëm jo vetëm në përmirësimin e gjendjes së mjedisit, por edhe të përmirësimit ekonomik dhe standardit jetësorë.

3.0. MENAXHIMI I MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË

3.1 Gjendja aktuale

Nga monitorimet e rregullta që AMMK bënë në terren me qëllim të vlerësimit të gjendjes së mjedisit, por edhe gjatë mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave nga raportet e menaxhimit të mbeturinave si: nga komunat, operatorët e licencuar për menaxhimim me mbeturina, KMDK, dhe të dhënave tjera relevante, vlerësojmë se gjendja e mbeturinave në Kosovë është duke u përmirësuar nga viti në vit.

Për të gjithë indikatorët e raportuar shohim se ka një përmirësim të shtura. Megjithatë, është vërejtur edhe ndikimi i Pandemisë Covid – 19 që ka rezultuar me një ngecje të vogël në përmirësimin e mëtutjeshëm të këtyre indikatorëve.

Pothuajse në të gjitha komunat është shënuar një përmirësim i madh sa i përket eliminimit të deponive të egra, pasi komunat kanë ndërmarrë aksione të pastrimit të këtyre lokacioneve, janë shtuar inspektimet dhe janë shqiptuar gjopa për qytetarët dhe operatorët, si dhe kanë vendosë tabela ndërgjegjësuese dhe informuese për parandalimin e hüdhes së mbeturinave.

Të dhënat që i kemi pranuar nga raportimi i komunave dhe operatorëve të licencuar, i kemi përpunuar përmes një procesi të vlerësuar mirë, me një përfshirje të gjithë ciklit të menaxhimit të mbeturinave, duke filluar nga gjenerimi e deri tek trajtimi përfundimtar i tyre, dhe në bazë të rezultateve të fituara shohim një përmirësim të treguesve.

Megjithate situata e menaxhimit të mbeturinave kërkon ende përmirësim të madhë, pasi ende ballafaqohemi me menaxhimin linear të mbeturinave. Pra, problem kyë mbetet ende fakti se mbeturinat që gjenerohen në mënyrë mbi 90% ende përfundojnë në deponi sanitare.

Edhe më tuje Kosova ballafaqohet me mungesën e iniciativave të mirëfillta qoftë në nivel lokal apo edhe në nivel vendi, drejtë menaxhimit të mbeturinave duke ndjekur ekonominë qarkore. Komunat nuk kanë krijuar kushte për ndarjen e mbeturinave në burim, hap ky i cili i paraprinë edhe riciklimit të mbeturinave.

Disa operatorë privat janë duke realizuar aktivitetet në mbledhjen e mbeturinave të klasifikuara, megjithate ky proces mëtepër është duke u mbulur nga sektori jo-formal, duke e bërë të paqartë dhe të vështirë monitorimin.

Si pasojë e mungesës së menaxhimit të integruar të mbeturinave, respektivisht iniciativës 3R (reduktim, ripërdorim & riciklim), kemi një mbingarkesë të deponive sanitare me mbeturina, ku bazuar në monitorimet që AMMK bënë çdo vit në këto deponi, është vlerësuar se gjendja mjedisore e tyre është tejmas e rënduar, e në disa prej tyre operojnë pothuajse jashtë çdo standardi.

Kjo gjendje e deponive sanitare ka ardhë edhe nga menaxhimi joadekuat, mungesa e investimeve rehabilituese, tejkalimi i kapaciteteve pranuese në deponi etj.

Duhet theksuar se edhe përkundër faktit që edhe viti 2021 është përcjellë me gjendjen e pandemisë Covid – 19, megjithatë janë shënuar rezultate pozitive në drejtim të treguesve të menaxhimit të mbeturinave.

Kështu, mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave në nivel vendi ka shënuar një rritje rreth 5% krahasuar me vitin paraprak duke arritur kështu në nivelin prej 90.02 %; numri i deponive të egra të regjistruara në vitin 2021 është zvogëluar me 426 më pak nga 1189 sa ishin në vitin 2020;

poashtu gjenerimi i mbeturinave nga 271.67 kg/banor /vit sa ishte në 2020 ka rënë në 251.16 kg/banorë/vit në 2021.

Në anën tjetër janë shënuar edhe disa përkeqësime siq është rasti me nivelin e arkëtimit ku kemi një rënie prej rreth 12% krahasuar me vitin 2020; niveli i përmbushjes së pajtueshmërisë ligjore ka shënuar një rënie të lehtë prej 1.4%, dhe një rritje mestare të sasisë së deponimit të mbeturinave në sasi prej 43,623 ton më shumë krahasuar me vitin 2020.

Kurse sa i përket ofrimit të infrastrukturës së komunave për të trajtuar mbeturinat e veçanta, siç janë ato shtazore, mjekësore, mbeturinat e ndërtimit dhe ato të vëllimshme, bazuar në raportet e mbledhura dhe pas analizimit të PKMM-ve është vlerësuar se komunat qëndrojnë keq në këtë drejtim. Poashtu, edhe sa i përket iniciativave për ndarjen e mbeturinave në burim komunat nuk kanë shënuar ndonjë progres të rëndësishëm.

Duhet të theksojmë që menaxhimi i mbeturinave komunale padyshim mbetet një sfidë për vendin dhe komunat, andaj kërkohet një inkurajim dhe përkrahim më të madhë në përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave.

Duhet të rritet bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve me nivelin qendrorë dhe ndërkomunal, duhet të shtohet bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm, në mënyrë që të rriten investimet dhe të realizohen projekte të qëndrueshme në menaxhimin e mbeturinave.

3.2 Gjenerimi i mbeturinave komunale

Prej 35 komunave që kanë raportuar mbi menaxhimin e mbeturinave për vitin 2021, është siguruar një bazë e mirë e të dhënave. Pas verifikimit dhe analizimit të këtyre të dhënave janë nxjerrë rezultate reprezentative të pasqyrimin të nivelit të gjenerimit të mbeturinave komunale sipas komunave dhe në nivel vendi për vitin 2021.

Megjithatë, duhet të potencojmë se nga këto dhëna edhe në këtë vit raportues nuk mund të nxjerrim një pasqyrë të kompozicionit të mbeturinave qoftë nëpër komuna individuale apo në nivel vendi, e po ashtu as të dhëna të diferencuara për sasinë e mbeturinave të gjeneruara nga zonat rurale apo urbane.

Sidoqoftë, bazuar në të dhënat e siguruar nga raportet e komunave dhe operatorëve, nga sasia totale e mbeturinave të gjeneruara mund të llogaritet një gjenerim mesatar i mbeturinave për banorë në nivel të komunave, rajoneve dhe në nivel vendi.

Kështu, bazuar në raportin për sasinë e mbeturinave të grumbulluara për vitin 2021 është rreth 469,390.00 ton. Duke pasur parasysh numrin e banorëve të shërbyer, është llogaritur norma e gjenerimit të mbeturinave komunale për kokë banori në ditë dhe në vit, që në nivel vendi rezulton 0.69 kg/banor/ditë, respektivisht 251.16 kg/banorë/vit.

Natyrisht se në sasinë e mbeturinave komunale të gjeneruara për vitin 2021, mund të ketë pasaktësi të caktuara për arsye si: tri komuna nuk kanë raportuar fare për vitin 2021, të dhënat për numrin e popullsisë janë të vjetëruara tashmë që nga regjistrimi i në vitin 2011, në disa komuna ka mospërputhje me numrin e banorëve sipas statistikave zyrtare me numrin real të banorëve që pranojnë shërbimin e mbeturinave etj.

Të dhënat e detajuara lidhur me sasinë e mbeturinave të grumbulluara dhe të gjeneruara janë dhënë në shtojcën 1 të raportit.





Figura 1. Gjenerimi i MK sipas rajoneve dhe në nivel vendi shprehur në kg/banor/vit, (2020 & 2021)

Tabela 1. Sasia e MK të gjeneruara dhe të grumbulluara 2021

Rajoni	Të dhëna të përgjithshme dhe të shërbimit			Sasia e mbeturinave të grumbulluara (2021)	Gjenerimi i mbeturinave (2021) ¹
	Numri i banorëve (ASK-2011)	Numri i ekonomive familjare (ASK-2011)	Numri i ekonomive familjare të shërbyera (12/2021)	Mbeturinat e përziera komunale të grumbulluara (kg/vit)	Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori (kg/vit)
R. I PRISHTINËS	470,583	85,104	119,225	144,272,430.00	229.33
R. I MITROVICËS	200,118	34,616	36,133	51,458,310.00	247.65
R. I PEJËS	174,235	30,266	28,653	62,078,000.00	376.13
R. I PRIZRENIT	387,828	60,651	67,054	99,076,300.00	230.73
R. I FERIZAJT	185,695	31,001	23,600	36,046,380.00	255.42
R. I GJILANIT	188,188	34,387	28,871	41,757,210.00	268.59
R. I GJAKOVËS	140,659	22,960	21,547	34,701,710.00	259.18
KOSOVË	1,747,306	298,985	325,083	469,390,340.00	252.12

¹ Gjenerimi bazohet në sasinë e mbeturinave komunale të grumbulluara, këtu nuk janë përfshirë në llogaritje mbeturinat që nuk grumbullohen dhe ato të vëllimshme.



Harta 1. Gjenerimi i MK në komuna shprehur në kg/banor/vit (2020 & 2021)

3.3 Deponimi i mbeturinave komunale

Sasia e mbeturinave komunale të deponuara në 7 deponitë sanitare në Kosovë, bazuar në raportimet e rregullta, në tabelën në vijim shohim se ka shkuar duke u rritur nga viti në vit, duke përjashtuar vitin 2020 ku kemi një rënie të vogël në trendin e deponimit.

Në vitin 2021 sasia e mbeturinave të deponuara krahasuar me vitin 2020 ka shënuar një rritje relativisht të madhe prej 43,623.00 ton më shumë.

Në deponitë që menaxhohen nga KMDK-ja, sasia e mbeturinave të deponuara për vitin 2021 është 375,983.00 ton/vit, duke shënuar një rritje prej vetëm 10% krahasuar me vitin 2020.

Ndërkaq, në deponitë e tjera sanitare që menaxhohen nga KRM-të, sasia e mbeturinave të deponuara është rreth 113,976.00 ton/vit, apo për rreth 8% më shumë krahasuar me vitin 2020.

Në total, sasia e mbeturinave komunale e deponuar në deponitë sanitare arrin në shkon në 489,955.00 ton/vit, me një rritje prej rreth 10%, respektivisht 43,623.00 ton më shumë mbeturina të deponuara se në vitin 2020.

Duhet të ceket se në këtë sasi të mbeturinave nuk është përfshirë sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë tjera jo sanitare, si ajo në Istog (Tuçep), apo në deponitë tjera në pjesën veriore të Kosovës, pasi nuk ka të dhëna të raportuara.

Tabela 2. Sasia e MK të deponuara/shprehur në ton

Deponitë Sanitare	2017	2018	2019	2020	2021
Prishtinë (Mirash)	116,355.77	126,351.47	150,921.83	152,215.43	181,215.42
Gjilan (Velekincë)	62,036.98	65,366.98	66,740.60	67,075.81	58,651.52
Podujevë (Dumnicë)	11,083.00	12,603.60	15,676.18	16,194.56	17,793.01
Prizren (Landovicë)	90,858.81	95,637.99	104,058.58	105,305.18	118,323.04
Nëntotali në deponitë e menaxhuara nga KMDK:	280,334.56	299,960.04	337,397.19	340,790.98	375,982.99
Mitrovicë (Gërmovë)	64,663.05	62,109.22	53,729.62	47,415.38	49,027.54
Pejë (Sferk)	47,926.00	49,451.00	52,688.00	52,496.00	57,752.00
Dragash (Sharr)	5,530.50	5,797.00	6,067.00	5,630.00	7,193.00
Nëntotali në deponitë e menaxhuara nga KRM-të:	118,119.55	117,357.22	112,484.62	105,541.38	113,972.54
Deponia në Istog (Tuçep) *	*	*	*	*	*
Deponia në Zveçan*	*	*	*	*	*
Zubin-Potokut (Lluçkarekë)*	*	*	*	*	*
Deponia në Leposaviq*	*	*	*	*	*
Gjithsej	398,454.11	417,317.26	449,881.81	446,332.36	489,955.53

*Nuk janë raportuar të dhëna për këto deponi.




Figura 2. Trendi i deponimit të mbeturinave komunale

3.4. Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale

Komunat përmes operatorëve të licencuar ofrojnë shërbimin themelorë të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave komunale dhe transferimin e tyre në deponitë sanitare për deponim.

Për vitin 2021, në tabelën dhe figurën në vijim është pasqyruar niveli i mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale sipas rajoneve, respektivisht sipas komunave. Kurse në hartën në vijim është dhënë një pasqyrë e shkallës së mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave sipas komunave.

Në formë më të detajuar në shtojcën 2 është paraqitur shkalla e mbulimit me shërbim të mbeturinave për të gjitha 35 komunat që kanë raportuar të dhëna të menaxhimit të mbeturinave për vitin 2021.

Deri në fund të vitit 2021, mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave për ekonomitë familjare në nivel vendi ka arritur në shkallën 90.2 %, (duke shënuar një rritje prej rreth 5% më shumë krahasuar me vitin 2020.

Rajoni i Prizrenit ka arritur shkallën më të lartë të mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale prej 96.5 %, i pasuar nga rajoni i Prishtinës dhe i Pejës me 94.7 %, kurse shkalla më e ulët e mbulimit me shërbim është shënuar në rajonin e Ferizajt me 76.1%.

Bazuar në të dhënat e raportuara në AMMK nga 35 komuna, dhe pas verifikimit të tyre është vlerësuar se 10 komuna kanë arritur në shkallën 100% mbulimin me shërbim të mbledhjes së mbeturinave.

Sa i përket indikatorit të mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave, duhet theksuar faktin se në këtë rast kemi disa pasaktësi të pashmangshme për shkak të dhënave zyrtare tashmë të vjetëruara nga ASK (regjistrimi i popullsisë 2011) sa i përket numrit të banorëve dhe ekonomive familjare në komuna, si dhe ndryshimit të madh në trendet e lëvizjes së popullsisë gjatë këtyre viteve.

Andaj, një numër i konsiderueshëm i komunave kanë numër më të madh të ekonomive familjare të cilat faturohen, në raport me numrin e përgjithshëm të ekonomive familjare të cilat merren si referencë nga ASK, si p.sh: Komuna e Prishtinës, Prizrenit, Fushë Kosovës, Vushtrisë, Graçanicës, Malishevës, Deçanit, Klllokotit etj.

Në anën një numër i komunave kanë marrë përsipër arkëtimin nga operatorët dhe kanë shfrytëzuar të dhënat e tatimit në pronë për procesin e arkëtimin, kështu që numri i ekonomive familjare është shumë më i madh se sa ai në regjistrimin e popullsisë dhe ekonomive familjare në vitin 2011, duke e ulur kështu saktësinë e vlerësimit të mbulimit me shërbim.

Sa i përket raportimit të komunave mbi nivelin e ofrimit të mbulimit me shërbimin e mbledhjes së mbeturinave për kategorinë e bizneseve dhe institucioneve, duhet cekur se shumë komuna ende nuk kanë arritur të bëjnë një filtrim të bizneseve aktive dhe atyre pasive, dhe në rastin tjetër nuk kanë ofruar të dhëna të llogaritshme sipas formatit të raportimit, çka ka ndikuar në pamundësinë e një vlerësimi adekuat të indikatorit.

Rrjedhimisht të dhënat për kategorinë e bizneseve dhe institucioneve janë pasqyruar në shtojcën 2 vetëm për disa komuna specifikesht.

Për llogaritjen e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave është përdorur përkufizimi i mëposhtëm:

$$SHm = \frac{N_{ef. sh}}{N_{p. ef.}} \times 100\%$$

* SHm Shkalla e mbulimit

* N ef.sh. – Numri i ekonomive familjare të shërbyera/ të faturuara në dhjetor 2020/2021

* N p.ef. – Numri i përgjithshëm i ekonomive familjare, sipas regjistrimit të popullsisë ASK-2011

Të dhënat e detajuara lidhur me shkallën e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale janë dhënë në shtojcën 2 në raport.

Tabela 3. Mbulimi me shërbim të mbledhjes së MK, (2020 & 2021)

RAJONI	Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave		
	Shkalla e mbulimit me shërbim për ekonomi familjare (2020)	Shkalla e mbulimit me shërbim për ekonomi familjare (2021)	Rritja ose zbritja e shkallës së mbulimit për ekonomi familjare 2020 -2021 (pikë %)
RAJONI I PRISHTINËS	89.2%	94.7%	5.5%
RAJONI I MITROVICËS	90.4%	92.8%	2.4%
RAJONI I PEJËS	87.6%	94.7%	7.1%
RAJONI I PRIZRENIT	94.2%	96.5%	2.3%
RAJONI I FERIZAJT	70.4%	76.1%	5.7%
RAJONI I GJILANIT	72.0%	81.6%	9.6%
RAJONI I GJAKOVËS	83.3%	88.5%	5.2%
KOSOVË	85.3%	90.2%	4.9%




Figura 3. Mbulimi me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK për ekonomitë familjare, (2020 & 2021)





Figura 4. Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK nga ekonomitë familjare, (2020 & 2021)



Harta 2. Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK sipas komunave, (2020 & 2021)

3.5. Faturimi dhe Arkëtimi

Menaxhimi efikas i mbeturinave kërkon qëndrueshmëri financiare të akterëve që janë të involvuar në menaxhimin e mbeturinave. Në këtë rast komunat dhe operatorët e licencuar që merren me mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave komunale ballafaqohen me vështirësi dhe paqëndrueshmëri financiare. Kjo paqëndrueshmëri financiare është vërejtur sidomos gjatë pandemisë Covid – 19 , e cila rezultoi me kriza të mëdha financiare në të gjithë sketoret, duke mos përjashtuar as sektorin e menaxhimit të mbeturinave.

Rritja e nivelit të arkëtitimit prej komunave dhe operatorëve nga menaxhimi i mbeturinave, planifikimi i duhur i tyre, dhe zvogëlimi i kostove operative, ndikojnë në rritjen e performancës së shërbimit dhe rrjedhimisht edhe përmirëimin e gjendjes në mjedis.

Bazuar në të dhënat e raportimit për vitin 2021, trendi i rritjes së shkallës së arkëtitimit për ekonomitë familjare ka shënuar një rënie të theksuar prej rreth 12 %. Kjo rënie e nivelit të arkëtitimit, padyshim se ka ndikuar edhe në gjendjen e operatorëve të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave, duke pasur parasysh edhe faktin e rritjes së çmimeve të karburanteve dhe mirëmbajtjes së pajisjeve.

Shkaqet e rënies së nivelit të arkëtitimit nuk janë shumë të qarta, por në një far mase ato mund të ndërlidhen me ndikimet e pandemisë Covid-19.

Krahasuar me vitin 2020 kur shkalla e arkëtitimit nga ekonomitë familjare ishte 90.84%, në vitin 2021 shkalla e arkëtitimit ka shënuar rënie me 12%, respektivisht ka arritur në 78.9%.

Në rastin e arkëtitimit për kategorinë e bizneseve dhe institucioneve shkalla e arkëtitimit nuk është llogaritur në nivel vendi për shkak të raportimit jo cilësorë, kështu që të dhënat janë pasqyruar në shtojcën 3 në raport për komuna individualisht aty ku ka qenë e mundur të bëhet verifikimi i të dhënave.

Sa i përket arkëtitimit sfidë mbetet ende fakti se operatorët nuk kanë mundur të bëjnë dallimin në mes të arkëtitimit nga faturimi për vitin përkatës dhe viteve të kaluara (borxhet e vjetra), andaj kjo e ka vështirësuar edhe pasqyrimin sa më real të shkallës së arkëtitimit për vitin 2021.

Në vitin raportues 2021, vetëm 4 komuna e kanë arritur ose tejkaluar shkallën 100 % të arkëtitimit për shërbim të mbledhjes së mbeturinave për ekonomitë familjare. Në disa komuna si Prishtina, Prizreni, Vushtria, krahasuar me vitin 2020 është shënuar rënie të nivelit të arkëtitimit madje edhe deri në 30%.

Në nivel të rajoneve, shkallën më të lartë të arkëtitimit për ekonomitë familjare gjatë vitit 2021 e ka arritur rajoni i Gjakovës me mbi 98 %, i pasuar nga rajoni i Pejës me 96%, kurse shkalla më e ulët e arkëtitimit është regjistruar në rajonin e Prishtinës me 68%, pasuar nga rajoni i Mitrovicës me 75.8%.

Të dhënat për shkallën e arkëtitimit janë llogaritur duke e përdorur formulën në vijim:

$$SHa = \frac{sh.f.l.v}{sh.f.a} \times 100\%$$

*SHa - Shkalla e arkëtitimit

*shf.l.v - Shuma e faturave të lëshuara në vit

*shf.a – Shuma e faturave të arkëtuara në vitin përkatës

Të dhënat e detajuara lidhur me shkallën e arkëtitimit janë dhënë në shtojcën 3 në raport.

Tabela 4. Faturimi dhe arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2021)

RAJONI	Faturimi për shërbim të ekonomive familjare	Arkëtimi për shërbim të ekonomive familjare
R. i PRISHTINËS	€ 6,385,807.13	€ 4,376,394.85
R. i MITROVICËS	€ 1,597,618.85	€ 1,211,641.86
R. i PEJËS	€ 1,544,674.00	€ 1,483,906.45
R. i PRIZRENIT	€ 3,187,137.37	€ 2,507,410.64
R. i FERIZAJIT	€ 1,360,710.68	€ 1,146,918.32
R. i GJILANIT	€ 1,281,609.60	€ 1,165,853.99
R. i GJAKOVËS	€ 1,189,123.20	€ 1,165,617.57
KOSOVË	€ 16,546,680.83	13,057,743.68

Tabela 5. Shkalla (%) e arkëtimit për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2020 & 2021)

RAJONI	Shkalla e arkëtimit 2020	Shkalla e arkëtimit 2021
R. i PRISHTINËS	89.62%	68.53%
R. i MITROVICËS	97.10%	75.84%
R. i PEJËS	90.47%	96.07%
R. i PRIZRENIT	92.05%	78.67%
R. i FERIZAJIT	89.50%	84.29%
R. i GJILANIT	89.88%	90.97%
R. i GJAKOVËS	89.32%	98.02%
KOSOVË	90.84%	78.91%




Figura 5. Arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2020 & 2021)





Figura 6. Arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2020 & 2021)



Harta 3. Shkalla e arkëtimit për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2020 & 2021)

3.6. Deponitë e egra

Një nga problemet që vazhdon ta përcjellë gjendjen e mjedisit në Kosovë është edhe prezenca e deponive të egra të cila shfaqen gjithandej në mjedis.

Me qëllim të evidentimit dhe regjistrimit të deponive të egra, gjatë muajit maj 2022, AMMK me mbështetjen e GIZ-së dhe me pjesëmarrjen e perfaqësuesve të komunave dhe zyrtarëve të kompanive rajonale, ka bërë evidentimin dhe regjistrimin e deponive të egra në 38 komunat e Kosovës.

Regjistrimi i deponive është bërë duke i marrë për bazë dy karakteristika: madhësinë dhe kompozicionin e mbeturinave.

Sipas madhësisë deponitë janë klasifikuar në tri kategori: deponi të mëdha, të mesme dhe të vogla. Ky klasifikim është bërë duke vlerësuar vizualisht vëllimin e deponive. Ndërsa sipas kompozicionit të mbeturinave, deponitë janë klasifikuar në: (a) deponi të mbeturinave komunale; (b) deponi të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit; (c) deponi të mbeturinave të rrezikshme; (d) deponi të mbeturinave të vëllimshme; dhe (e) deponi të mbeturinave të tjera.

Në këtë proces në 38 komuna janë regjistruar gjithsej 763 deponi të egra të madhësive të ndryshme, ku dominojnë kategoria e deponive të vogla me gjithsej 270 të tilla, ndërsa sipas kompozicionit dominojnë kategoria e emëruar si të tjera me 40%.

Në rajonin e Prizrenit është regjistruar numri më i madh i deponive të egra me gjithsej 187 kurse në Rajonin e Gjakovës është regjistruar numri më i vogël i deponive me gjithsej 30 deponi.

Ndërkaq sipas komunave, numri më i madh i deponive të egra është regjistruar në komunën e Lipjanit me gjithsej 88 deponi, e prirë nga komuna e Malishevës me 84 deponi, kurse në Komunën e Vitisë dhe Junikut nuk është regjistruar asnjë deponi e egër.

Duhet të theksohet se vit pas viti është duke u shënuar progres i theksuar në pastrimin e deponive egra, dhe poashtu gjithnjë e më pak shohim se po krijohen deponi të reja. Në këtë progres ka ndikuar angazhimi i shtuar i komunave dhe kompanive të menaxhimit të mbeturinave, por edhe rritja e vetëdijes qytetare për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit. Kështu, krahasuar me 1184 deponi të egra të regjistruara në maj 2021, në regjistrimin e fundit të realizuar në qershor 2022 numri i deponive të egra ka shënuar një rënie prej 426, pra janë evidentuar dhe regjistruar 763 deponi të egra gjithsej në nivel vendi.

Të dhënat e detajuara për deponitë e egra janë dhënë në shtojcën 4 në raport.

Tabela 6. Numri i deponive të egra ndër vite sipas rajoneve

RAJONI	2018	2019	2020	2021
RAJONI I PRISHTINËS	582	313	277	150
RAJONI I MITROVICËS	221	222	101	118
RAJONII PEJËS	342	141	156	68
RAJONI I PRIZRENIT	448	298	256	187
RAJONI I FERIZAJT	158	127	118	99
RAJONI I GJILANIT	377	325	242	111
RAJONI I GJAKOVËS	118	63	39	30
KOSOVË	2246	1489	1189	763




Figura 7. Numri i deponive të egra sipas rajoneve dhe në nivel vendi

Tabela 7. Deponitë e egra sipas kompozicionit, 2021

RAJONI	Mbeturina komunale	Mbeturinat të ndërtimit dhe demolimit	Mbeturinat indust. dhe të rrezikshme	Mbeturinat të vëllimshme	Mbeturinat tjera
RAJONI I PRISHTINËS	27.0%	41.1%	0.0%	0.6%	31.3%
RAJONI I MITROVICËS	46.4%	19.5%	1.2%	1.4%	31.5%
RAJONII PEJËS	46.3%	19.3%	0.3%	0.0%	34.0%
RAJONI I PRIZRENIT	8.2%	33.5%	0.4%	0.0%	57.9%
RAJONI I FERIZAJT	27.3%	37.2%	0.0%	1.1%	34.3%
RAJONI I GJILANIT	28.8%	24.3%	0.0%	0.9%	46.1%
RAJONI I GJAKOVËS	5.0%	27.5%	0.0%	0.0%	67.5%
KOSOVË	28.0%	30.8%	0.3%	0.8%	40.1%





Figura 8. Deponitë e egra sipas kompozicionit në nivel vendi (%)



Harta 4. Deponitë e egra sipas komunave, 2021

3.7. Efikasiteti i kostos së menaxhimit të mbeturinave komunale

Menaxhimi racional burimeve financiare dhe kapaciteteve teknike janë njëkohësisht shumë të lidhura ngushtë me qëndrueshmërinë operuese dhe ofrimin e shërbimeve të duhura në të njëjtën kohë.

Efikasiteti i kostos, është një tregues i rëndësishëm, ku përmes këtij treguesi shohim se si komunat, respektivisht operatorët ofrojnë shërbime efikase të menaxhimit të mbeturinave, dhe në anën tjetër krijojnë stabilitet të operimit, duke bërë një paralogaritje ideale për vendosjen e një tarife shërbimi që mbulon kostot e shërbimit.

Cilësia dhe qëndrueshmëria e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave mund të përkoqësohen rëndë nëse shërbimet nuk ofrohen në një mënyrë ekonomike dhe me kosto efektive, dhe në rastin kur ofrimi i shërbimeve është joefikas, ai është një tregues i cili duhet të adresohet në aspektin e menaxhimit sidomos atij financiar dhe operativ.

Kostot për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave janë të ndryshme në secilën komunë. Secila komunë i ka karakteristikat e veta, si: tipologjia e ofrimit të shërbimeve, topografia e terrenit, dallimet sociale, infrastruktura etj. Prandaj, efikasiteti i kostos së ofrimit të shërbimit për secilën komunë është i lidhur ngushtë nga karakteristikat e sipër cekura, dhe nga niveli i ngarkesës tarifore për ofrimin e shërbimit.

Komunat dhe ofruesit e mandatuar të shërbimeve raportojnë mbi efikasitetin e kosotove për shërbimin e ofruar, bazuar në analizën dhe vlerësimet e tyre të brendshme për kostot e krijuara gjatë vitit operues. Në vlerësimin e këtij raportimi në procedurën e praktikuar të vlerësimit në AMMK, komunave dhe operatorëve u kërkohet që kostot e krijuara gjatë vitit raportues ti mbështesin me dokumentacion relevant dhe të besueshëm. Relevante për llogaritjen e kostove të ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave janë kostot që ekskluzivisht i faturohen këtij shërbimi.

Treguesii efikasiteti i kostos së menaxhimit të mbeturinave komunale është dizajnuar që të llogaritet për sasinë e mbeturinave të mbledhura në ton/vit. Mirëpo, operatorët e mandatuar për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave komunale nuk kanë arritur që raportimin ta mbështesin me të dhëna dhe dokumentacion të besueshëm, andaj në këto rrethana, pas shqyrtimit të raporteve, për llogaritjen e efikasitetit të kosotos është marrë për bazë numri i stafit të ofruesit të shërbimeve për 1000 klient (njësi) të shërbyer. Një pasqyrë më e detajuar e kostos së ofrimit të shërbimit është paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela 8. Efikasiteti i kostos së menaxhimit të mbeturinave, 2021

Komuna	Stafi i Ofruesit të Shërbimeve	Klientët e shërbyer	Efikasiteti i stafit per 1,000 konsumatore të shërbyer
Prishtine	259	79,143	3
Drenas	51	8,160	6
Fushe Kosove	58	14,273	4
Gracanice	79	4,409	18
Lipjan	63	10,810	6

Obiliq	42	3,575	12
Podujeve	57	10,170	6
Mitrovica	219	14,358	15
Skenderaj	46	5,951	8
Vushtrri	76	17,265	4
Mitrovica e Veriut*	-	0	-
Zvecan	50	1,827	27
Zubin Potok*	-	0	-
Leposaviq*	-	0	-
Pejë	129	19,667	7
Istog	36	6,779	5
Klinë	36	6,490	6
Prizren	242	39,832	6
Suharekë	74	9,662	8
Malishevë	103	8,145	13
Rahovec	50	11,615	4
Dragash	59	4,990	12
Mamushë	11	481	23
Ferizaj	272	15,973	17
Kaçanik	74	4,138	18
Shtime	36	3,363	11
Hani i Elezit	25	1,484	17
Shterpce	15	1,492	10
Gjilan	62	17,219	4
Kamenicë	16	4,813	3
Viti	16	5,295	3
Novo Brdo	7	1,190	6
Partesh	12	1,038	12
Klllokot	6	939	6
Ranillug	3	975	3
Gjakovë	142	16,129	9
Deçan	49	8,169	6
Junik	11	1,083	10
Gjithsej	2,486	360,902	7

*Komunat nuk kanë raportuar



3.8. Sistemet e ndara për mbeturina të veçanta

Treguesin: *sistemet e ndara për mbeturina të veçanta*, është viti i dytë që komunat e raportojnë në AMMK.

Qëllimi i këtij indikator është që të vlerësohet komunat se si dhe sa kanë nisur angazhimet e tyre që të krijojnë infrastrukturë për menxhimin e rrymave të veçanta të mbeturinave, dhe këtu në radhë ta parë hyjnë: mbeturinat e ndërtimit dhe demolimit, mbeturinat e vëllimshme, nënproduktet e kafshëve dhe mbetjet e kujdesit shëndetësorë.

Përmes këtij treguesi maten iniciativat e komunave që në planifikimet investive për menaxhimin e mbeturinave të fusin edhe këto rrjedha të mbeturinave, të cilat janë një pjesë e veçant, relativisht komplekse, por edhe e një rëndësie shumë të madhe për ruajtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.

Këto rryma të mbeturinave komunat i kanë përfshirë në PKMM me prioritet, andaj edhe indikator synon vlerësimin se në çfar shkalle komunat kanë qenë në gjendje të përmbushin e zbatimit të këtyre planeve.

Bazuar në vlerësimin e raportimit të mbeturinave për vitin 2021, dhe duke e analizuar realizimin e PKMM-ve, me fokus në këto rryma të mbeturinave, kemi gjetur se në përgjithësi komunat nuk i kanë pasqyruar saktë prioritetet e menaxhit të këtyre rrymave.

Kjo është konstatuar nga fakti se komunat nuk i kanë definuar mirë seksionet e veçanta të planifikimit të niveleve të shërbimit, modeleve operacionale, vlerësimin të kostos dhe financimit (përfshirë alokimin buxhetor) dhe investimet e nevojshme, por edhe në ato raste kur i kanë definuar mirë, nuk kanë ndërmarrë hapa në realizimin e tyre.

Kështu, gjatë shqyrtimit të PKMM-ve për secilën komunë që ka raportuar është bërë vlerësimi duke gjetur se sa komunat i kanë përfshirë këto rryma të mbeturinave në PKMM dhe në çfar niveli i kanë pasqyruar në seksionet si: qëllimin, objektivat, masat/aktivitetet dhe buxhetin e alokuar për menaxhimin e tyre.

Rezultatet e këtij indikator janë paraqitur në tabelën në vijim për secilën komunë. Kështu, për komunat që është vlerësuar se kanë ofruar një përshkrim të qartë të këtyre rrymave të mbetjeve në PKMM janë vlerësuar me vlerën 1, kurse në disa komuna edhe pas shqyrtimit të PKMM-ve është vlerësuar nuk i kanë planifikuar dhe harmonizuar qartë ose në disa raste nuk janë përfshirë fare, në këto raste vlerësimi është dhënë me vlerën 0.

Tabela 9. Sistemet e ndara për mbeturina të veçanta, 2021

Komunat	Sisteme të ndara për mbeturina të veçanta				
	Vlerësimi i përgjithshëm				
	Mbeturinat nga Ndërtim Demolimi	Mbeturinat e Vëllimshme	Mbeturinat shtazore, nën-produktet shtazore	Mbeturinat mjekësore	Gjithsej vlerësimi
Prishtinë	4	4	3	3	14
Drenas	4	4	3	4	15
Fushë Kosovë	0	0	0	0	0
Gracanice	0	0	0	0	0
Lipjan	0	0	0	0	0

Obiliq	0	0	0	0	0
Podujeve	3	3	3	3	12
Mitrovica	0	0	0	0	0
Skenderaj	0	0	0	0	0
Vushtrri	0	0	0	0	0
Mitrovica e Veriut	0	0	0	0	0
Zvecan	0	0	0	0	0
Zubin Potok	0	0	0	0	0
Leposaviq	0	0	0	0	0
Pejë	3	3	3	3	12
Istog	0	0	0	0	0
Klinë	0	0	0	0	0
Prizren	0	0	0	0	0
Suharekë	0	0	0	0	0
Malishevë	0	0	0	0	0
Rahovec	4	4	0	0	8
Dragash	0	0	0	0	0
Mamushë	3	3	0	0	6
Ferizaj	0	0	0	0	0
Kaçanik	0	0	0	0	0
Shtime	3	0	1	4	8
Hani i Elezit	3	0	0	0	3
Shterpce	0	0	0	0	0
Gjilan	3	3	3	3	12
Kamenicë	0	0	0	0	0
Viti	0	0	0	0	0
Artanë	0	0	0	0	0
Partesh	0	0	0	0	0
Klllokot	0	0	0	0	0
Ranillug	0	0	0	0	0
Gjakovë	4	4	2	2	12
Deçan	4	4	4	3	15
Junik	0	0	0	0	0
Gjithsej	38	32	22	25	117

3.9. Ndarja e mbeturinave në burim - Riciklimi

Ndarja e mbeturinave në burim edhe më tutje mbetet një nga aspektet e menaxhimit të mbeturinave ku komunat ende nuk kanë filluar që të ndërmarrin iniciativa për nisjen e zbatimit të këtij hapi që paraqet qelësin drejt fillimit të menaxhimit të integruar të mbeturinave. Në mungesë të zbatimit të ndarjes së mbeturinave në burim, nuk mund të zhvillohet një sistem i qëndrueshëm i riciklimit të mbeturinave, i cili është një nga hallkat kryesore të zhvillimit të ekonomisë qarkore.

Nga shqyrtimi i të dhënave të raportuara nga komunat dhe operatorët për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2021 sikurse edhe në vitet paraprake, është vlerësuar se pothuajse në asnjë komunë nuk është duke u zbatuar ndonjë sistem i mirëfillt i mbledhjes së ndarë të mbeturinave të gjeneruara.

Edhe në ato pak komuna që kanë raportuar për një aktivitet të tillë, megjithatë ajo është vlerësuar se nuk është e qëndrueshme dhe më tepër janë iniciativa në kuadër të fushatave pilotuese, por jo diçka e qëndrueshme.

